



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4731/24 datë:16.02.2024



Npi – 01/73 datë: 26.02.2024

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 date 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas procesit të diskutimit Publik, në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2024, Miratoi këtë:

V E N D I M

PËR APROVIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2024

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më: 26.02.2024, unanimisht, miratoi Rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2024.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/68, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/69.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi